

**AKT – THEMELIMI  
(KONTRATË)  
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË  
KUFIZUAR**

**“ Ita Market ” SH.P.K**

**Ne:**

Unë, **Ueda Behari**, e dtl. 22/04/1997, lindur në Shkodër dhe banuese në Bulevardi Zogu i I, Shkodër, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi Nr. 032956703, dhe nr personal ID: J75422074W, e vlefshme deri më : 11/11/2025.

kem vendosur:

**Neni 1**

Të themelojmë një shoqëri tregtare me përgjegjisi të kufizuar për të ushtruar veprimtarinë ekonomike e emërtuar **“ Ita Market ” SH.P.K** me ortak të vetëm:

Zj. Ueda Behari, e dtl. 22/04/1997, lindur në Shkodër dhe banuese në Bulevardi Zogu i I, Shkodër, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi Nr. 032956703, dhe nr personal ID: J75422074W, e vlefshme deri më : 11/11/2025.

**Neni 2**

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar pa TVSH dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës të derdhur në kapitalin themelor.

**Neni 3**

Shoqëria e ka selinë e saj në Shkodër, La. Nr. 1, Rruga Hamz Kazazi, nr pasurie 2/301, zona kadastrale 8591, nr ndërtese 74. Shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filjal, përfaqësi, degë, si dhe t'i suprimojë ato.

**Neni 4**

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me kufi të pacaktuar e mbi 10 vjet. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë me vendim të ortakëve.

**Neni 5**

Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë do të jetë 100.000 lekë (njëqindmijë), kapital i cili është i formuar tërësisht nga ortakët themelues të saj. Kuotat e kapitalit janë të ndara në 1 pjesë të barabart me vlerë 100.000 lekë (njëqindmijë) lekë .

Secili nga ortakët zotërojnë:

Ortaku i vetëm Ueda Behari zotëron 1 kuotë me vlerë totale 100.000 lekë, (njëqindmijë)që mban 100% të kapitalit.

## **Neni 6**

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga ortakët. Rritja e kapitalit të ortakut nuk është e kufizuar.

## **Neni 7**

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor do të shlyhen në llogarinë e subjektit sapo të rregjistrohet dhe të hapet nr i llogarisë në një bankë të nivelit të dytë në teritorin e republikës së Shqipërisë.

## **Neni 8**

Objekti i aktivitetit ekonomik do të jetë:  
Tregëtimin me pakicë të artikujve të ndryshëm ushqimorë dhe industrial.  
Market ushqimorë dhe artikuj të tjerë të ndryshëm.

## **Neni 9**

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit, që lidhet midis palëve në mbështetje të ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 (Kodit të Punës), si dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të tij.

## **Neni 10**

Ortakët nuk kufizohen në rritjen e kapitalit të shoqërisë.

## **Neni 11**

Shoqëria vepron në rregjimin e pronës dhe merr përsiper të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues mbartin rrezikun e veprimtarisë së Shoqërisë në nivelin e kapitalit të investuar në Shoqëri.

## **Neni 12**

Mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të shoqërisë midis ortakëve dhe në mes të Shoqërisë dhe punonjësve brenda saj, si dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, çështja mbetet në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

## **Neni 13**

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë percaktuar dhe inicialet e emertimit të saj.

## **Neni 14**

Organet e shoqërisë **“ Ita Market ” SH.P.K** janë :  
Ortakët e shoqërisë.  
Administratori i shoqërisë.  
Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i shoqërisë do të jetë zj. **Ueda Behari**, e dtl. 22/04/1997, lindur në Shkodër dhe banuese në Bulevardi Zogu i I, Shkodër, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi Nr. 032956703, dhe nr personal ID: J75422074W, e vlefshme deri më : 11/11/2025.

Modalitete për ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga statuti i shoqërisë, ligji 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe statuti i shoqërisë, ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

Ky akt – Themelim është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

**Datë, 04.07.2024**

**THEMELUESI :**

**Ueda Behari**



**STATUTI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TË**  
**KUFIZUAR**

**“ Ita Market ” SH.P.K**

Shoqëria **“ Ita Market ” SH.P.K** është krijuar mbi bazen e Akt-Themelimit të Ortakëve, Shoqërisë ,

Unë, **Ueda Behari** , e dtl. 22/04/1997, lindur në Shkodër dhe banuese në Bulevardi Zogu i I, Shkodër, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi Nr. 032956703, dhe nr personal ID: J75422074W, e vlefshme deri më : 11/11/2025.

kam vendosur:

Kem vendosur të përpiloje këtë Statut si më poshtë:

**Neni 1**

Shoqëria është quajtur **“ Ita Market ” SH.P.K**

Ajo është një person juridik Shqipëtar, e cila do të ushtroje aktivitet privat në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë pas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

Shoqëria **“ Ita Market ” SH.P.K** zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqipëtar dhe me aktet e themelimit të saj (Akt – Themelimi dhe Statuti).

Ortakët themelues në këtë sipermarrje kanë derdhur kapitalin e tyre, me qëllim që të përfitojnë të ardhura, që mund të vijnë nga ushtrimi i veprimtarisë private, si dhe të përballojnë deri në kufirin e vleftës së derdhur në kapitalin themelor.

**Neni 2**

Objekti i aktivitetit ekonomik do të jetë:

Tregëtimin me pakicë të artikujve të ndryshëm ushqimorë dhe industrial.  
Market ushqimorë dhe artikuj të tjerë të ndryshëm.

**Neni 3**

Për kryerjen e veprimtarisë së saj Shoqëria do të hapi një njësi shërbimi e tregtimi, duke bashkëpunuar me persona fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj.

**Neni 4**

**SELIA**

Shoqëria e ka selinë e saj në Shkodër, La. Nr. 1, Rruga Hamz Kazazi, nr pasurie 2/301, zona kadastrale 8591, nr ndërtese 74.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filial, përfaqësi, degë, si dhe ti suprimojë ato.

## **Neni 5**

### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqëria Tregtare Privatë **“Ita Market” SH.P.K** do të ketë një kohëzgjatje me kufi të pacaktuar dhe mund të shpërbëhet në çdo kohë.

## **Neni 6**

### **KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë do të jetë 100.000 lekë (njëqindmijë), kapital i cili është i formuar tërësisht nga ortakët themelues të saj. Kuotat e kapitalit janë të ndara në 1 pjesë të barabart me vlerë 100.000 lekë (njëqindmijë) lekë .

Secili nga ortakët zotërojnë:

Ortaku i vetëm Ueda Behari zotëron 1 kuotë me vlerë totale 100.000 lekë, (njëqindmijë) që mban 100% të kapitalit.

## **Neni 7**

Pjesët e kapitalit themelor janë plotësisht të tranferueshme në rrugë trashëgimie, në rast ndarje pasurore ndërmjet bashkëshortëve, paraardhësve, pasardhësve.

Të gjitha pjesët e kapitalit të Shoqërisë mund t’u kalojnë ,t’u tranferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në ortakëri, por gjithmonë me vendim të ortakëve dhe me akt noterial.

Trashëgimtari hyn në Shoqëri me të gjitha të drejtat e ortakut dhe me të gjitha efektet.

## **Neni 8**

Kapitali i shoqërisë përbëhet nga kapitali themelor, dhe të tjera të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë tregtare. Të gjitha pjesët e kapitalit themelor janë tërësisht të shlyeshme dhe të nënshkrueshme nga ortakët e shoqërisë.

## **Neni 9**

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë do të administrohet nga ortakët. Një pjesë të këtij fitimi mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit tregtar. Shoqëria është e detyruar të shlyej të gjitha detyrimet që ka ndaj shtetit dhe të tretëve.

## **Neni 10**

### **ORAGNIZIMI DHE ADMINISTRIMI NË SHOQERI**

Ortakët e vetëm të Shoqërisë janë:

**Ueda Behari** , e dtl. 22/04/1997, lindur në Shkodër dhe banuese në Bulevardi Zogu i I, Shkodër, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi Nr. 032956703, dhe nr personal ID: J75422074W, e vlefshme deri më : 11/11/2025.

Organi vendimor është vendimet e ortakëve të marra në Asamblenë e Oratkëve

Ortakët vendosin për çështje të tilla si, emërimi dhe shkarkimi i Administratorit, shkarkimin e ekspertëve kontabel të autorizuar dhe likujduesve, miratimi i raportëve të administrimit dhe kontrollit, miratimi i llogarive, ndryshimet në Statut, zvogëlimi i kapitalit themelor tek të tretët, të veprimtarisë së Shoqërisë

apo likujduesi i saj, shndërrimi i Shoqërisë në një formë tjetër të parashikuar nga ligji, ndryshimi i vendodhjes së selisë, si dhe shtimi apo pakësimi i objektit të aktivitetit të shoqërisë.

### **Neni 11**

Asamblea e Oratkëve mbledhjet e zakonshme i bën çdo vit, brenda katër muajve nga mbyllja e veprimtarisë ekonomike të Shoqërisë.

Asamblea e Oratkëve mund të mbledhet në çdo moment që mund të kërkohet nga njëri nga ortakët për të trajtuar ose kërkuar marrjen e vendimeve.

### **Neni 12**

#### **ADMINISTRATORI**

Administrator i Shoqërisë do të jetë zj. **Ueda Behari**, e dtl. 22/04/1997, lindur në Shkodër dhe banuese në Bulevardi Zogu i I, Shkodër, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi Nr. 032956703, dhe nr personal ID: J75422074W, e vlefshme deri më : 11/11/2025.

Administratori qëndron për një periudhë 5 (pesë) vjeçare në detyrë.

Mandati i tij mund të jetë i rinovueshëm.

Ortakët gëzojnë të drejtën në çdo kohë të shkarkojë nga detyra administratorin me vendim e Asamblesë së Ortakëve dhe të emerojë një tjetër në vend të tij.

Administratori mundet në çdo moment të emerojë një zëvendës, ta revokojë dhe të emërojë një tjetër në vend të tij.

Administratori ka kompetenca:

Të kontrollojë e të zbatojë dispozitat ligjore në fuqi që i referohen në tërësi aktivitetit të shoqërisë. Zbaton planet dhe llogaritë ekonomike pas vendimarrjes së ortakut të vetëm në bazë të objektit të aktivitetit të shoqërisë.

Përfaqëson shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët, vendas dhe të huaj, nënshkruan kontrata etj. .

Të përmbushë të gjitha dispozitat ligjore në lidhje me sigurinë në punë, duke qenë gjithashtu e deleguar që të verifikojë e kontrollojë përmbushjen e të gjitha detyrimeve ligjore nga ana e shoqërisë, duke përdorur kur është rasti edhe teknikë profesioniste të posaçme jashtë shoqërisë,

Të kryejë të gjitha operacionet e zakonshme bankare, hapje mbyllje llogarie në bankat e nivelit të dytë në territorin e Shqipërisë, kryen të gjitha transaksionet bankare brenda dhe jashtë vendit pa kufizim, të lëshojë çeqe apo të kryejë pagesa nëpërmjet veprimeve bankare apo të kujdeset për tërheqjen e efekteve apo faturave bankare, të kryejë të gjitha transaksionet me prezencë fizike, veprime me kartë si dhe në sistemet elektronike bankare.

Të kerkojë dhënie e leljen e kredive në të ashtequajturat institute të kreditit, të lidhë kontrata huamarrje e të faktoringut për lëshimin e kredive duke u koordinuar me Ortakët.

Të përfaqësojë shoqërinë në gjykimet aktive e pasive, të zakonshme e administrative si edhe në përgjithësi para çdo selie e shkalle me të drejtë emërimi të avokatëve, përfaqësuesve ligjorë, konsulentëve teknik për këtë qëllim, duke u koordinuar me Ortakët.

Të kryejë të gjitha transfertat dhe pagesat dalese të parave në çfarëdo shume dhe monedhe, konfirmimi i blerjeve, konfirmimi i listë pagesave, marrëdhëniet me organet shtetërore dhe organet tatimore, marrëdhëniet me palët e treta private, marrëdhëniet me bankat. Çdo vendim e veprim juridik i mësipërm është i zbatueshëm dhe mund të autorizojë person tjetër për përfaqësimin dhe kryerjen e këtyre veprime.

## **Neni 13**

### VITI FINANCIAR, LLOGARITË VJETORE DHE REZERVA E DOMOSDOSHME

Çdo vit financiar fillon me 1 Janar të çdo viti dhe perfundon me 31 Dhjetor, me përjashtim të vitit të parë, ku si fillim është data e regjistrimit të shoqërisë.

## **Neni 14**

Llogaritë vjetore, inventaret, raportët mbi operacionet e vitit financiar dhe raportët e veçanta të hartuara nga administratorët, apo nga ekspertët kontabel miratohen nga ortaku i vetëm. Miratimi i dokumentëve financiare vjetorë bëhet brënda një afati 3-mujor, të mbylles së vitit financiar.

## **Neni 15**

Mbas miratimit të llogarive vjetore të vertëtimit të ekzistencës së fitimit, por mund të krijojë edhe fonde të tjera.

Shoqëria për kontributin fiskal, afatet e derdhies së sigurimeve shoqërore, etj. .

Ajo ka të drejtë të çeli llogari likujduese pranë bankave të vendit dhe të kryej veprime likjudimi me to.

## **Neni 16**

### **MARRËDHENIET E PUNËSIMIT DHE LIDHJA E**

#### **KONTRATAVE**

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit, që lidhet midis palëve në mbështetje të ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 (Kodit të Punës), si dhe legjislacionit tjetër Shqipëtar që bën fjalë për punësimin.

## **Neni 17**

Marrja në punë bëhet me regjistrimin nga punëdhënësi në librin e punës së Shoqërisë, si dhe duke njoftuar organet e punës të juridiksionit ku ushtron veprimtarinë Shoqëria.

## **Neni 18**

Largimi nga puna bëhet me mbarimin e kontratës së punës, për shkelje disiplinore, ose me vetë kërkesën e të intërsuarit. Largimi nga Shoqëria bëhet mbasi janë shlyer të gjitha detyrimet materiale dhe monëtare. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punës bëhet në bazë të një akti me shkrim.

## **Neni 19**

Shoqëria mund të lidhi kontrata me sektore shtetërore, si dhe me persona fizike ose juridike, vendas ose të huaj.

Në veprimet kontraktuale Shoqëria perfaqesohet nga administratori, ose nga një person tjetër i autorizuar prej tij me prokure. Të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga kontratat janë të detyrueshme për shoqërinë.

## **Neni 20**

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi emërohen një ose disa likuiditorë të cilët ndjekin operacionët e likuidimit deri në fund dhe i paraqesin Asamblesë së Ortakëve dhe administratorit rezultatet perfundimtare të likuidimit. Në përfundim Asambleja e Ortakëve vendos për heqjen e mandatit të tyre. Të gjitha detyrimet që dalin nga likuidimi, ortakët i marrin përsipër për ti shlyer me kapitalin e tyre.

## **Neni 21**

Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë kur ato nuk mund të zgjidhen me mirkuptim, do të kalojnë në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gyqesor Shkodër.

## **Neni 22**

Transferimi i Shoqërisë nga një formë në një tjetër bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kur plotësohen kushtet për krijimin e Shoqërisë të llojeve të tjera.

## **Neni 23**

Themeluesit e Shoqërisë mund të bëjnë ndryshime e plotësime me Statut dhe në aktin e themelimit pa rënë ndesh në menyre thelbësore në çdo kohë, me nenet e përshkruara në këtë Statut. Ndryshimet e plotësimet bëhen në të njëjtën mënyre e procedurë me të cilën nxirret vetë statuti.

## **Neni 24**

Çeshtjet e tjera që nuk janë trajtuar në këtë statut, gjithçka i referohet ligji 9901 datë 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe statutë i shoqërisë, ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Per Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit”, legjislacionit Shqipëtar në fuqi, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

## **Neni 25**

Ky statut është përpiluar dhe firmosur në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

**Datë, 04.07.2024**

**ORTAKËT THEMELUES**

**Ueda Behari**

